



Pranimi / Dorezuar Prijemno/Prodato Received/Delivered	28.07.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ/Jednitca Org./Unit	Nr Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHICK	5444	2023	1/9



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.801/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti, zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.801/2023, të datës 01.06.2023, të parashtruar nga ankuesja [redacted] kundër organit të punësimit: Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.07.2023, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.801/2023, e datës 01.06.2023, e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokollit 517, i datës 05.05.2023, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

### A r s y e t i m

Nëpunësja civile, [redacted] (tutje vetëm ankuesja), më datë 01.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.Nr.801/2023, kundër Vendimit me numër protokollit 517, të datës 05.05.2023, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Kushtetuese, për shkak të shkeljeve të dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.04/2013, Ligjit Nr.5/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregullores Nr.04/2015 për Procedurat e Rekrutimit, të Emërimit dhe të Punës Provuere të Stafit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli), në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 06.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Gjykata Kushtetuese të Republikës së

Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 14.06.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër protokoll 5130/2023 të datës 12.07.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokoll 4562/2023 të datës 01.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.517 të datës 05.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me Nr.ref.219/23 të datës 08.02.2023 të Komisionit Disiplinor; Ankesën e ankueses të datës 10.03.2023 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Kushtetuese; Vendimin me Nr.541 të datës 12.05.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm; Ankesën me Nr.354-2 të datës 23.05.2023 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin e Ankesave në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; Akt Emërimit me Nr.551 të datës 15.05.2023; Procesverbalin nga takimi i seancës disiplinore të datës 12.01.2023; Procesverbalin nga takimi i seancës disiplinore të datës 27.10.2022; Vendimin për emërimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Njësisë së Prokurimit me Nr.SP-1410/18/bo të datës 27.09.2023; Akt Emërimit me Nr.Ref: SP 2018/20 të datës 10.12.2020; Formularin e vlerësimit të kryerjes së punës për ankuesen të datës 21.12.2018; Udhëzimin për plotësimin e raportit; Raportin vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2021; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën 01.01.2021 deri 31.12.2021; Realizimin e planit individual vjetor të punës për vitin 2020 të datës 21.12.2020; Formulari i vlerësimit të performances për ankuesen për periudhën kohore 01.01.2019 deri 31.12.2019; Shkresën zyrtare të drejtorisë së prokurimit të datës 20.12.2023; Raportin i NJAB-“Funksionimi i Kontrollit të Brendshëm në NJP” për vitin 2021 me Nr.554 të datës 29.03.2022; Raportin e Auditimit të Brendshëm të datës 28.03.2022; Draftin e Auditimit të Brendshëm të datës 18.02.2022; Shtojcën I: Letër e Konfirmimit me Nr.ref.:SP836/22 të datës 12.05.2022 të lëshuar nga Sekretari I Gjykatës Kushtetuese; Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin 2021 të përpiluar në muajin Maj 2022; me korrespondim prej 1-14 faqe; Rregullorja Nr.001/2022 për Prokurimin Publik me numër protokoll 82/2022 të datës 20.10.2022; Draftin e Auditimit të Brendshëm- Formulari numër :3001/1 të datës 18.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese; Shtojcën II: Shpjegim lidhur me llojet të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit me korrespondim prej 1-3 faqe; Shkelje flagrante e ligjit të prokurimit rreth procesit tenderues (kërkesë për sqarim) e datës 17.09.2021 e dërguar me e-mail nga [info@spinagency.com](mailto:info@spinagency.com) për \_\_\_\_\_, Gjykatën Kushtetuese, \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_; Përgjigje në e-mail e datës 15.05.2023 e dërguar nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_; E-mail i datës 17.09.2021 të dërguar nga \_\_\_\_\_ për V.D; Amandamentimin e kontratës publike kornizë 243238-21-8581-1-2-1/C56 të datës 28.02.2022 të lëshuar nga Sekretariati I Gjykatës Kushtetuese; Furnizimin, shtypjen e broshurave dhe materialeve tjera për shtypje me Nr.Prokurimi 243238-21-8581-1-2-1 dhe Nr. I Brendshëm 243238/21/024/121; Rregulloren NR.04/2013 për procedurat disiplinore dhe të ankimit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës me numër ref.:SP:1682/13 e datës 20.09.2013; Vendimin e komisionit disiplinor me Nr.Ref.:2191/22 të datës 18.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.06.2023 të dërguar nga Këshilli I Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 354-3 të datës 13.06.2023 të dërguar nga Gjykata Kushtetuese për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me korrespondim prej faqe 1-19; Autorizimin me numër protokoll 692 të datës 13.06.2023 të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese;

Raporti i Auditimit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2021 me numër protokoll 787; Kërkesën për informacion/dokumentacion me numër protokoll 02-03/3366/22 të datës 10.08.2022 të Agjencisë për parandalimin e korrupsionit; Kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore me numër protokoll 1848 të datës 03.10.2022 të Agjencisë për parandalimin e korrupsionit; Vendimin e Komisionit Disiplinor të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me numër reference 2191/2022 të datës 18.11.2022; Kërkesën për inicim të procedurës disiplinore ndaj zyrtares [redacted] në bazë të Raporteve të Brendshme të Auditimit dhe Raporteve mbi Funkcionimin e Sekretariatit me numër protokoll 2526/2022 të datës 29.12.2022 të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Vendimin për themelimin e Komisionit Disiplinor me numër ref.:SP-940/22/an të datës 26.05.2022 të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Vendimin për zëvendësim të anëtarit të komisionit disiplinor me numër ref.:S.P-2157/22 të datës 16.11.2022 të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Vendimin për emërimin e anëtarit ad hoc të komisionit disiplinor me numër ref.:SP:2527/22 të datës 29.12.2022 të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj Drejtoreshës [redacted] të dërguar me e-mail të datës 29.12.2022 nga [redacted] për [redacted] dhe [redacted] Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj Drejtoreshës V.H të dërguar me e-mail të datës 29.12.2022 nga [redacted] për [redacted] dhe [redacted] Vendimin për themelimin e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave me numër ref.:SP-941/22/an të datës 26.05.2022 të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Vendimin për emërimin e anëtarit ad hoc të komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Njoftimin për pranimin e ankesës të dërguar me e-mail të datës 15.03.2023 nga [redacted] për [redacted] dhe [redacted]; Njoftimin për caktimin e anëtarit ad-hoc Komisioni I Ankesave të dërguar me e-mail të datës 15.03.2023 nga [redacted] për [redacted] Dorëzimin e vendimit të Komisionit Disiplinor, nr.ref.: 219/23 të datës 13.02.2023; Shtyrjen e afatit për vendimin e komisionit disiplinor të dërguar me e-mail të datës 30.01.2023 nga [redacted] për [redacted]; Ftesën për seancën disiplinore të dërguar me e-mail të datës 11.01.2023 nga [redacted] për [redacted]; Njoftimin për fillimin e seancës disiplinore të dërguar me e-mail të datës 29.12.2022 nga [redacted] për [redacted]; Akt emërimin me numër ref.:SP 1833/11/shb të datës 07.10.2011 të [redacted] të lëshuar nga Sekretariati I Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Përshkrimi I detyrave të punës për pozitën "Zyrtar për prokurim"; Akt emërimin me numër ref.:SP 1580/19 të datës 26.08.2019 të [redacted] të lëshuar nga Sekretariatit I Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Vendimin për emërimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Njësisë së Prokurimit me numër ref.:SP-1410/18/bo të datës 24.09.2018 të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Vendimin për vazhdimin e mandatit të emërimit të ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Njësisë së Prokurimit me numër ref.:SP-2023-1/16/bot të datës 24.12.2018 të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Vendimin për vazhdimin e mandatit të ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Njësisë së Prokurimit me numër ref.:SP547-1/19 të datës 22.03.19 të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Vendimin për vazhdimin e mandatit të ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Njësisë së Prokurimit me numër ref.:SP 1176/20 të datës 06.07.2020 të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Akt emërimin me numer ref.SP 2108/20 të datës 10.12.2020 të [redacted] të lëshuar nga Sekretariati I Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Vendimin për themelimin e komisionit disiplinor me numër ref.:SP-940/22/an të datës 26.05.2022 të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Ankesën e parashtruar nga [redacted] ankuesja për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Kushtetuese kundër Vendimit Nr.219/23 të datës 08.02.2023; Vendimin me numër protokoll 030/11.01.2023 të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Marrëveshje për ndërprerjen e kontratës publike kornizë e datës 11.01.2023 në mes Gjykatës Kushtetuese dhe Operatorit Ekonomik " ONE Sh.P.K"; Akt emërimin me numër ref.:Sp 1555/19 të datës 26.08.2019 të [redacted] të lëshuar nga Gjykata

Kushtetuese e Kosovës; Akt emërimin me numër ref.:Sp 2099/21 të datës 01.10.2021 të M.S të lëshuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës; Akt emërimin me numër ref.:SP 1573/19 të datës 26.08.2019 të [redacted] të lëshuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës; Vendimin për emërimin e anëtarit ad hoc në komisionin për zgjidhje të kontesteve dhe ankesave me numër ref.:SP-2528/22 të datës 29.12.2022 të Sekretariati të Gjykatës Kushtetuese; Akt emërimin me numër protokolli 179 të datës 01.02.2023 të [redacted] të lëshuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës; Akt emërimin me numër ref.:SP 1551/19 të datës 26.08.2019 të [redacted] të lëshuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës; Akt emërimin me numër ref. SP 1567/19 të datës 26.08.2019 të [redacted] të lëshuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës; Vendimin për ndryshimin e akt-emërimeve të punës së personelit të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese numër ref:SP-1531/19 të datës 21.08.2019; Formularin e vlerësimeve të rezultateve të punës për periudhën nga 1 janar deri 31 dhjetor 2021 të [redacted] të datës 24.12.2021; Raportin vjetor për kontratat e nënshkruara publike të vitit fiskal 2021 të menaxheres së prokurimit [redacted], Formulari I vlerësimit të performancës për periudhën 1 janar deri 10 dhjetor 2020- u.d Drejtor I NJP dhe 10 dhjetor deri 31 dhjetor 2022 Drejtore e NJP të [redacted]; Realizimi I planit individual vjetor të punës për vitin 2020 të datës 12.12.2020 i [redacted]; Formulari I vlerësimit të performancës për periudhën 1 janar deri 31 dhjetor 2022 të datës 30.12.2022 të [redacted]; Realizimin e planit individual vjetor të punës për vitin 2022 të [redacted] Raportin vjetor për kontratat e nënshkruara publike të datës 15.11.2022 të V.H; Përgjigjen në ankese me numër protokolli 801/2023 të datës 14.07.2023 të Sekretariatit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Organogramin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; Akt emërimin e [redacted] me numër protokolli 551 të datës 15.05.2023 të lëshuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës; Vendimin me numër protokolli 541 të datës 12.05.2023 të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; Formulari për punësim i datës 28.10.2020 I [redacted] në Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Certifikatën me numër 20/267 të datës 29.12.2003 të [redacted] të lëshuar nga Universiteti I Prishtinës-Fakulteti Ekonomik; CV e [redacted] së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Letër Motivim e [redacted], Vendimin me numër ref.:SP-1176/20 të datës 06.07.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese; Vendimin me ref.nr.:DANJ-629/11/shb të datës 01.04.2011 të Sekretares së Përgjithshme të Gjykatës Kushtetuese; Kontratë e marrëdhënies së punës në mes [redacted] dhe Sekretariati të Gjykatës Kushtetuese me numër 410/2010 të datës 01.04.2010; Kontratë e marrëdhënies së punës në mes [redacted] dhe Institutit të Kosovës për Administratë Publike me numër 04/2008 të datës 08.06.2008; Kontratë e marrëdhënies së punës në mes V.H dhe Institutit të Kosovës për Administratë Publike me numër 03/2005 të datës 03.06.2005; Kontratë e marrëdhënies së punës në mes [redacted] dhe Ministrisë së Shërbimeve Publike me numër 1/2004 të datës 09.06.2004; Formulari I vlerësimit të kryerjes së punës së [redacted] të nxjerr me datë 21.12.2018 nga Sekretariati I Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; Formulari I vlerësimit të performancës të [redacted] të datës 20.12.2019; Kopje e Letërnjoftimi e [redacted], Certifikatë me numër 280 e lëshuar nga KRPP dhe IKAP; Certifikatë me numër 350 e lëshuar nga KRPP dhe IKAP; Certifikatë me numër 398 e vitit 2014 e lëshuar nga IKAP; Certifikatë me numër 434 e lëshuar nga IKAP; Certifikatë me numër 401 e vitit 2010 e lëshuar nga IKAP; Certifikatë e lëshuar nga IKAP e vitit 2009; Certifikatë e vitit 2008 e lëshuar nga IKAP; Certifikatë e datës 27.12.2006 e lëshuar nga Departamenti i Thesarit; Certifikatë e lëshuar nga Instituti Kosovar për Menaxhim; Certifikatë e datës 07.05.2008 e lëshuar nga IKAP; Certifikatë e datës 28.05.2017 e lëshuar nga " Policy Menagment Consultin" L.L.C; Certifikatë e datës 21-22.10.2016 e lëshuar nga "EIPAA"; Certifikatë e datës 11-14.03.2016 e lëshuar nga "FLSA"; Certifikatë e Muajit Janar 2009 e lëshuar nga IKAP; Certifikatë e muajit Mars 2015 e lëshuar nga IKAP; Certifikatë e datës 20-23.04.2011 e lëshuar nga Instituti Kosovar për Menaxhim; Certifikatë e datës 16-23.03.2007 e lëshuar nga IKAP; Certifikatë e datës 13.12.2010 e lëshuar nga

Departamenti I Thesarit; Certifikatë e datës 04.02.2011 e lëshuar nga Departamenti i Thesarit; Certifikatë e datës 27.12.2006 e lëshuar nga Departamenti I Thesarit; Shpalljen e konkursit të brendshëm për pozitën Drejtor i Njësisë së Prokurimit të datës 26.10.2020; Formularin për punësim në Sekretarin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës t' me datë 08.02.2010; Letër motivuese e me datë 14.01.2010; Certifikatë me numër 20/267 e datës 29.12.2003 e V.D; Vendimin me numër protokoll 214 të datës 01.04.2010 i lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Informim me numër protokoll 215 të datës 01.04.2010 i lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Letër Referencë e datës 12.01.2010; Katalog i përshkrimit të detyrave të punës të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese me korrespondim prej faqe 1-62, Raportin I të datës 29.09.2022 për Funksonimin e Sekretarisë së Gjykatës Kushtetuese, ( pjesa e shkëputur nga raporti dhe referuar çështjeve sipas ankueses) Raportin II të datës 02.11.2022 për Funksonimin e Sekretarisë së Gjykatës Kushtetuese pjesa e shkëputur nga raporti dhe referuar çështjeve sipas ankueses, si dhe Vendimin me numër VK/2023 të datës 12.07.2023 të Kryetarit të Këshilli i Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së pretendimet ankimore të ankueses janë të *pabazuara, sepse:*

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja është e punësuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (GJKK) dhe së njëjta sipas Aktit të Emërimit Nr.Ref: SP 2018/20 të datës 10.12.2020 është emëruar në pozitën Drejtor e Njësisë së Prokurimit, në Departamentin e Prokurimit.

Me tej, nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Gjykatën Kushtetuese, me datë 29.12.2022 përmes shkresës me numër Ref.nr:SP-2526/22, ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurë disiplinore ndaj ankueses, mbi bazën e supozimit së e njëjta ka kryer shkelje të rëndë disiplinore, me arsyetimin së sipas raporteve të auditimit është konstatuar së ankuesja në cilësi të zyrtares përgjegjëse të prokurimit ka nënshkruar Kontratën për "Furnizimin dhe shtypjen e broshurave dhe materiale tjera për shtypje" në vlerës prej 450.000 eurove, vlerë kjo që është dashur të jetë 45.000 euro, dhe së vlera përkatëse nuk është shënuar më shkronja, ka shpallur me gabime teknike kriteret e tenderimit për Kontratën "Shërbime për strehimin (hostimin), programimin dhe mirëmbajtjen e web faqes së gjykatës" si pasojë e të cilave në gjykatë kishte dorëzuar ankesë më 17 shtator 2021 njeri nga operatorët ekonomik, ka nënshkruar më 7 shtator 2021 Kontratën për "Mbikëqyrjen e projekteve për rinovimin e hyrjes, korridoreve në objektin e gjykatës", në të cilën çmimi i kontratës i shënuar më fjalë kishte qenë gabim dhe nuk përkonte me çmimin e shënuar me numra, dhe se me 26 tetor 2021, ka nënshkruar Kontratën për "Shërbime fotografimi, kornizimi dhe shërbime të xhirimit" në të cilën çmimet e produkteve ishin më të larta sesa çmimet e tregut, dhe rrjedhimisht kjo kontratë tani është në procedurë të shkëputjes.

Komisioni Disiplinor, në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, me Vendimin Nr.ref:219/23 të datës 08.02.2023, ka shpallur përgjegjës ankuesen për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 4 pika 1.2 dhe pika 1.13 të Rregullores Nr.04/2013 për Procedurat Disiplinore dhe të Ankimit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës si dhe nenit 3 pika 3.1 a) të Kodit të Etikës të Nëpunësit Civil të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke shqiptuar masën disiplinore "Ndërrimi i zyrës dhe i pozitës dhe transferimi në një vend tjetër pune me detyra dhe me nivel të ngjashëm pune".

E pakënaqur me Vendimin Nr.219/23, të datës 08.02.2023, të Komisionit Disiplinor, ankuesja me datë 10.03.2023, ka parashtruar ankesë të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa, ky i fundit, me Vendimin me Nr.Prot.517 të datës 05.05.2023, ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar, duke lënë në fuqi masën e shqiptuar ndaj të njëjtës.

Në kuptim të vërtetimit të pranueshmerisë së ankesës Kolegji i'u referua nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA) më të cilin përcaktohet se: *Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj, dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës konstaton se ankesa A.nr.801/2021 është e pranueshme, ngase ankuesja ka legjitimitetin e palës për të ushtruar ankesë dhe se ankesa është ushtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1, të LPPA-së, dhe si rrjedhojë Këshilli ka juridiksion për trajtimin e çështjes sipas ankesës më numër A.nr.801/2021, ashtu siç përcaktohet me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se Vendimi me numër protokoli 517, i datës 05.05.2023, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Kushtetuese, është nxjerrë me shkelje të dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.04/2013, Ligjit Nr.5/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregullores Nr.04/2015 për Procedurat e Rekrutimit, të Emërimit dhe të Punës Provuere të Stafit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Shton se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore është bazuar tërësisht në draft raportin e auditimit të brendshëm për funksionin e kontrollit të brendshëm në Njesisë e Prokurimit të datës 18.02.2022 duke konstatuar se vlera në euro është shënuar vetëm me numra dhe me fjalë dhe se nuk ka marrë për bazë raportin final të auditimit, ku kjo e gjetur nuk është evidentuar, e njëjta thekson se pika e 3 e vendimit të kundërshtuar i referohet gabimeve teknike të përsëritura për të konstatuar shkeljen e rëndë disiplinore, ku gabimi në fjalë është i pakuptimtë edhe për tu lexuar e aq më tepër për tu ndëshkuar, po ashtu pretendon se në pikën e 4 të vendimit të Komisionit Disiplinor i njëjti merr vendim thuajse për problemet me kontratën në fjalë ku shumica e pagesës prej 398.25 duke theksuar (treqindë e nentëqindë e tetëqind euro e njëzet e pesë cent) ka qenë gabim i zyrës së prokurimit, përderisa në fakt gabimet kanë qenë të operatorit ekonomik, rrjedhimisht anulimi i kontratës ka ardhur me marrëveshje dy palëshe pra është shkëputur kontrata, po ashtu e njëjta rekomandon që të merren parasysh dëshmitë e ofruara për refuzimin e vendimit të Komisionit Disiplinor si të pabazuara duke theksuar faktin që gabimet teknike janë gabime njerëzore dhe që gabimet janë evidentuar dhe rregulluar duke mos shkaktuar asnjë implikim ligjor, administrativ procedural apo financiar. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, ta refuzoj si të pabazuar Vendimin me Nr.ref:219/23 të datës 08.02.2023 të Komisionit Disiplinor, ta kthej të njëjtën në pozitën si Drejtore e Departamentit të Prokurimit si dhe t'i kompensohen pagat sipas rregullave dhe procedurave retrospektive të vendimit në fjalë.

Bazuar në shkresat e lëndës rrjedhë së Njësia e Burimeve Njerëzore ka njoftuar ankuesen lidhur me kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj saj, duke informuar të njëjtën me shkeljet e pretenduara disiplinore, veprim ky i paraparë me nenin 12 të Rregullores Nr.04/2013 për Procedurat Disiplinore dhe të Ankimit në Gjykatën Kushtetuese. Po ashtu, palës ankuese i është

dhënë mundësia e deklarimit dhe të parashtrimit të fakteve mbrojtëse, e drejtë kjo e garantuar me nenin 9 dhe 11 të LPPA-së.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të bazueshmërisë së pretendimeve ankimore ka analizuar aktin e kontestuar me ankesë në ndërlidhje me provat materiale të kësaj çështje juridiko administrative dhe si rrjedhojë ka konstatuar së Komisioni Disiplinor ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen e fakteve dhe ka zbatuar drejtë ligjin material, ngase sipas shkresave të lëndës përkatësisht sipas Raporteve të Auditimit të Brendshëm të datës 18.02.2022 dhe 28.03.2023, Raportin I të datës 29.09.2022 për Funksonimin e Sekretarisë së Gjykatës Kushtetuese si dhe Raportin II të datës 02.11.2022 për Funksonimin e Sekretarisë së Gjykatës Kushtetuese, janë evidentuar këto të gjetura: Në kontratën për *"Furnizimi, shtypja e broshurave dhe materialeve tjera për shtypje"* e kontraktuar më datë 10.12.2021, vlera e parashikuar në njoftimin për nënshkrimin e kontratës është përcaktuar 45.000.00 euro, ndërsa në Kontratën e lidhur Publike -Kornizë me nr.243238-21-8581-1-1-2-1/C56 , neni 4, vlera e çmimit të kontratës është shënuar 450,000.00 euro, dhe së çmimi është shënuar vetëm më numër e jo me fjalë, po ashtu nga provat materiale si me lartë rezulton së gabime të ngjashme ishin evidentuar edhe të Kontrata *"Renovimi i hyrjes dhe korridoreve të objekti të Gjykatës Kushtetuese"* ku vlera e kontratës me shkronja ishte shënuar gabim, ndërsa të kontrata për *"Shërbime për strehimin (hostimin), programimin dhe mirëmbajtjen e web faqes së gjykatës"*, janë gjetur gabime në kriteret e tenderimit, si rezultat i të cilave organi i punësimit ishte i detyruar që të anulonte aktivitetin e prokurimit.

Për me tepër nga shkesat e lëndës, Kolegji vëren së organi i punësimit më datë 26.10.2021 kishte lidhur Kontratën Publike - Kornizë me numër 243238-21-27239-221/C52 për *"Shërbime fotografimi, kornizimi dhe shërbimi të xhirimit"*, me operatorin ekonomik "One SHPK", ndërsa e njëjta kontratë më datë 11 janar 2023 është ndërprerë, mu për shkak të rekomandimeve të vet ankueses në pozitën e Drejtoreshës së Prokurimit, me arsyen se çmimet sipas kësaj kontratë janë më të larta se çmimet e tregut. Ndërlidhur me këtë aktivitet të prokurimit, organi i punësimit në përgjigjen në ankesë ka deklaruar së ka pasur vakum të ofrimit të shërbimeve sipas kësaj kontratë në kohëzgjatje prej një vit e gjysme për çka dhe Gjykata Kushtetuese ka mbetur pa shfrytëzim të këtyre shërbimeve shumë të nevojshme për punën dhe funksionimin e saj. Përkitazi, me pajtueshmërinë ligjore të anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit, Kolegji i Këshillit thekson faktin së i njëjti nuk ka juridiksion ligjor të trajtimit, mirëpo Kolegji i Këshillit veprimet e tilla i mori parasysh në kuptim të pasojave administrative në raport me organin e punësimit.

Andaj, nisur nga gjendja e fakteve si me sipër, Kolegji i Këshillit vlerëson së nuk kanë mbështetje pretendimet e ankueses se janë gabime teknike të evidentuara vetëm me draft raporte dhe si të tilla nuk kanë implikime buxhetore dhe financiare, ngase në vlerësimin e Kolegjit gabimet e përsëritura teknike, bartin me vete humbje të resurseve materiale dhe kohore dhe si të tilla atakojnë edhe imazhin e institucionit, i cili duhet të veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.

Po ashtu, nga provat materiale lidhur me këtë çështje juridiko administrative rrjedh së ankuesja me Vendimin Nr.ref.2191/22 të datës 18.11.2023, është shpallur përgjegjëse për shkelje të rëndë disiplinore, sipas nenit 4, pika 1.2 dhe nenin 6, pika 1.13 të Rregullores nr.04/2013 për Procedurat Disiplinore dhe të Ankimimit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës si dhe nenit 3, pika 1.1 a) të Kodit të Etikës së Nëpunësit Civil të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,

duke vendosur që t'i shqiptohet masa disiplinore "Ndalim i avancimit deri në dy (2) vite". Rrjedhimisht, procedura disiplinore ishte iniciuar bazuar në kërkesën e Agjencisë Kundër Korrupsionit të datës 03.10.2022, kurse Komisioni Disiplinor kishte konstatuar së specififikimet teknike lidhur me aktivitetin e prokurimit "furnizim me aparate telefoni/smartphone" me nr.të prokurimit 243238/21-6289-1-3-6, nuk janë hartuar në harmoni me nenin 28.2 dhe 28.7 të Ligjit për Prokurimin Publik, me të cilin është përcaktuar se: 28.2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specififikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specififikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. 28. 7. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specififikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specififikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim njëjft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent".

Një shkelje e tillë e procedurave të prokurimit, e konstatuar sipas Vendimin Nr.ref.2191/22 të datës 18.11.2023, nga Komisioni Disiplinor i Gjykatës Kushtetuese ishte gjetur edhe me Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare të Gjykatës Kushtetuese, për vitin 2021, ku citojmë "Çështja A1-Gjetja;... në procedurën e prokurimit "furnizim me aparate telefoni/smartphone" në vlerë prej 8.880 euro, GJKK me rastin e përcaktimit të specififikimeve teknike në dosjen e tenderit, kishte përdorur kritere favorizuese të cilat kishin eliminuar konkurrencë. Kjo pasi që, tek specififikimet teknike ishin vendosur të gjitha tiparet e telefonit që kategorizojnë brendin Iphone dhe për me tepër, tek modeli i kërkuar ishte specifikuar edhe emri i brendit përkatës.


Rrjedhimisht, nisur nga këto fakte dhe konstatime, Kolegji i Këshillit vlerëson së Komisioni Disiplinor ka vepruar në përputhshmëri me nenin 13 të Rregullores Nr.04/2013 për Procedurat Disiplinore dhe të Ankimit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar se: 1. Komisioni Disiplinor ka këto kompetenca: 1.1 Të dëgjojë dhe të shqyrtoj provat përkitazi me shkeljen e supozuar; 1.2 Të vendos, në bazë të provave, nëse është kryer shkelja; dhe 1.3 të përcaktoj dënimin që duhet shqiptuar, përkatësisht Komisioni Disiplinor ka cilësuar drejtë veprimet e ankueses si shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 4 pika 1.2 dhe pika 1.13 të Rregullores Nr.04/2013 për Procedurat Disiplinore dhe të Ankimit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës si dhe nenit 3 pika 3.1 a) të Kodit të Etikës të Nëpunësit Civil të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, dhe së masa disiplinore e shqiptuar është e drejtë dhe në proporcion me shkeljet disiplinore të konstatuara, kështu që mbi këtë bazë, Kolegji i Këshillit konstaton së Vendimi me numër protokolli 517, i datës 05.05.2023, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës është nxjerrë më vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, duke zbatuar në këtë mënyrë drejtë ligjin material, andaj, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05-L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje



Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.801/2023

Ardita Perçuku-Shyti  
  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.